

# EQD/EDNJ PËR DREJTORË



## Ndërgjegjësimi

E diskutueshmja është fakt i jetës - pëqafoje atë!

## Përgatitja

E diskutueshmja është në zemër të të nxënit!

## Veprimi

Të gjithë të lirë të flosin hapur!

# ÇËSHTJET E DISKUTUESHME



## Çështjet e diskutueshme

Si drejtor do ta dini më mirë se shumica, se polemika është një fakt i pashmangshëm i jetës në shkolla sot. Përdorimi i medias sociale dhe formave të menjëhershme të komunikimit i sjell nxënësit në kontakt të përditshëm me çështjet si migrimi, ndryshimet klimatike, terrorizmi dhe të drejtat e personave LGBT. Trajtimi i çështjeve si këto mund të jetë sfidues, por si mund t'i kuptojnë të rinjtë këto çështje nëse nuk u lejohej t'i diskutojnë në shkollë? Si do të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike apo të debatojnë në mënyrë demokratike nëse nuk kanë një mësues për t'i udhëzuar? Diskutimi i çështjeve të diskutueshme ka shumë përfitime, por nuk është një detyrë për t'u marrë me lehtësi. Ndër të tjera, ju duhet një staf i trajnuar mirë, një kurrikulë e duhur dhe një etos i shkollës që është mbështetës.

### Materiali në këtë seksion në masë të madhe bazohet në dy doracakë të Këshillit të Evropës:

Pakoja e trajnimit "Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme" është në dispozicion për t'u shkarkuar në: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/charter-edc-hre-pilot-projects/teaching-controversial-issues-developing-effective-training-for-teachers-and-school-leaders>

Mjeti i vetëvlerësimit "Menaxhimi i të diskutueshmes" është në dispozicion për t'u shkarkuar në: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/charter-edc-hre-pilot-projects/project-1-managing-controversy-a-whole-school-training-tool>

Çështjet e diskutueshme - Tema 1: Çështjet e diskutueshme në shkollë

## Çështjet e diskutueshme – Çfarë dhe ku?

Kontradikta është më shumë se një mosmarrëveshje e përditshme ose dallim në opinion. Është diçka që ngjall emocione të forta, si dhe shkakton ndjenjë të pakëndshme dhe ndarje midis njerëzve.

Kontradiktat janë pjesë e natyrshme e jetës në një demokraci dhe në çdo komunitet që e vlerëson lirinë e shprehjes, duke përfshirë shkollat.

Kontradiktat ndryshojnë sipas kohës dhe vendit. Ato ndryshojnë gjithashtu sipas shkallës, nga ato lokale në ato globale.



Ndonjëherë një polemikë mund të lindë vetë në shkollë. Për shembull, njerëzit mund të mos pajtohen me:

- çfarë mësohet në shkollën tuaj, p.sh. evolucionin,
- rregullat e shkollës suaj, për shembull, për atë që veshin nxënësit,
- të marrurit tuaj me komunitetin lokal, p.sh., trajtimi i nxënësve migrantë

Si drejtor, ju me të drejtë do të shqetësoheni për mënyrën se si trajtohen çështjet e diskutueshme në shkollën tuaj - qoftë në një diskutim në klasë, në një debat në parlamentin e nxënësve, ose në një takim të prindërve. Duhet të jeni të vetëdijshëm për pasojat nëse gjërat dalin nga dora dhe për dëmin që mund t'ia shkaktojnë reputacionit të shkollës suaj.

Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme për ju që të:

- kuptoni rreziqet e trajtimit të çështjeve të diskutueshme
- monitoroni çështjet që mendoni se mund të jenë të diskutueshme
- mësoni stafin tuaj se si t'i menaxhojnë me mençuri çështjet e diskutueshme

Çështjet e diskutueshme - Tema 1: Çështjet e diskutueshme në shkollë

## Çështjet e diskutueshme – Pse është mirë të flitet?

Është joshëse që të përpiqeni të qëndroni larg çështjeve të diskutueshme në shkollë. Ju mund të mendoni se diskutimi i këtyre çështjeve në mënyrë të hapur, vetëm do të krijojë më shumë ndjenja të pakëndshme, që nxënësit nuk do të jenë në gjendje t'i përballojnë, ose se do të ketë ankesa.

Kjo nuk është mënyra demokratike. **Mënyra demokratike e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve të opinionit është të flisni për to.** Është e rëndësishme që të diskutohen çështjet, në mënyrë të hapur dhe me respekt. Të mësuarit se si të bëhet kjo, është një nga mësimet më të rëndësishme që një shkollë mund ta ofrojë.

Më poshtë janë disa arsye të tjera pse mund të jetë mirë të flitet për çështje të diskutueshme në shkollë. Cilat mendoni se janë më të rëndësishmet? Mundohuni t'i renditni ato në një shkallë nga 1-10. Ky është një ushtrim që mund ta bëni edhe me nxënësit, stafin ose prindërit.

1. Zhvillon kompetencën e të menduarit kritik dhe analitik	
2. I përgatit nxënësit të merren me kontradiktat, që me gjasë, do t'i ndeshin në të ardhmen	
3. U jep nxënësve një mundësi për t'u shprehur	
4. I ndihmon nxënësit të krijojnë një ide të asaj që shohin e dëgjojnë në media sociale	
5. I ekspozon nxënësit ndaj të kuptuarit më të gjerë të botës	
6. I bën mësimet shkollore më realiste dhe të përditësuara	
7. I bën nxënësit të ndihen të vlerësuar nga shkolla dhe shoqëria	
8. I ndihmon nxënësit të respektojnë njerëzit me pikëpamje dhe sfond të ndryshëm	
9. Nxjerr në pah dezinformatat dhe lajmet e rreme në media sociale	
10. U jep nxënësve vetëbesim dhe ndjenjë të vetefikasitetit	

Sigurisht, kjo nuk do të thotë që të gjitha çështjet, sado të diskutueshme, duhet të diskutohen në shkollë. Ajo që tregon ky ushtrim është se ka shumë për t'u përfituar nga biseda përmes çështjeve të diskutueshme në shkollë, nëse mund t'i trajtoni ato në mënyrë të sigurt.



Çështjet e diskutueshme - Tema 1: Çështjet e diskutueshme në shkollë

## Çështjet e diskutueshme – Për çfarë duan të flasin njerëzit në shkollën tuaj?

Një mënyrë për ta adresuar nevojën për të diskutuar seriozisht rreth çështjeve të vështira, është duke gjetur se për çfarë njerëzit në shkollën tuaj me të vërtetë duan të flasin. Këtu është një hulumtim që mund ta përdorni me mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Ai i ndan çështjet e diskutueshme në tri lloje - ato që lidhen me mësimet, me jetën e përditshme të shkollës dhe me marrëdhëniet prind-shkollë. Kur t'i keni rezultatet, mund të ndërmerri hapa për të nisur biseda rreth çështjeve që duket se janë më urgjente.

	Mësuesit	Nxënësit	Prindërit
<b>Mësimet</b>			
<b>Jeta e përditshme shkollore</b>			
<b>Marrëdhëniet prind- shkollë</b>			



*Çështjet e diskutueshme - Tema 2: Trajtimi i çështjeve të diskutueshme në mënyrë të sigurt*

## **Menaxhimi i çështjeve të diskutueshme në klasë – Çfarë aftësish u duhen mësuesve?**

Për të qenë në gjendje t'i trajtojnë çështjet e diskutueshme në mënyrë të sigurt në klasë, mësuesit kanë nevojë për një varg aftësish. Këto përfshijnë:

- si t'i zgjedhin çështjet për diskutim
- si të merren me bindjet dhe paragjykimet e tyre personale
- si t'u përgjigjen shprehjeve raciste, seksiste dhe shprehjeve të tjera nënçmuese
- si ta lehtësojnë diskutimin paanshëm
- si t'i inkurajojnë nxënësit t'i shohin këndvështrimet tjera
- si t'i mësojnë nxënësit që t'i diskutojnë çështjet me respekt
- si të parandalojnë shpërthimin e emocioneve në klasë
- si të përballen kur u mungon ekspertiza për një çështje.



Kërkoni nga stafi juaj i mësimdhënies që t'i vlerësojnë aftësitë e tyre më të dobëta sa i përket të qenit në gjendje për t'u marrë me çështjet e diskutueshme. Përdorni këtë informacion si bazë për t'i zgjedhur format e duhura të **zhvillimit profesional**, kur të krijohen mundësitë.

Çështjet e diskutueshme - Tema 2: Trajtimi i çështjeve të diskutueshme në mënyrë të sigurt

## Menaxhimi i çështjeve të diskutueshme në klasë – Ide për praktikë

Menaxhimi i diskutimit të një çështjeje të diskutueshme në mënyrë të sigurt në klasë kërkon një varg aftësish nga mësuesi. Këtu janë 4 ide për **aktivitete trajnuese** që do të ndihmojnë në zhvillimin e disa prej këtyre aftësive të stafi tuaj mësimdhënës.

### 1. Si të merremi me bindjet dhe paragjykimet personale të dikujt

Jepuni mësuesve një përzgjedhje fotografish të fytyrave të njerëzve (të prera nga revistat). Pyetini, “Cili është terroristi?” dhe kërkojuni t’i shpjegojnë proceset e tyre të menduarit në arritjen e një përgjigjeje. Më pas shpjegojuni se nuk ka përgjigje të saktë. Besimet dhe anshmëritë e shprehura janë të gjitha në kokat e mësuesve. Vazhdoni duke u kërkuar mësimdhënësve që të përpiqen të identifikojnë besimet dhe anshmëritë që mund t’i kenë në lidhje me çështjet specifike të diskutueshme që mund t’i hasin në shkollë.

### 2. Si t’u përgjigjemi shprehjeve raciste dhe shprehjeve të tjera nënçmuese

Jepni disa skenarë në të cilët nxënësit shfaqin shprehje raciste ose shprehje të tjera nënçmuese. Kërkojuni mësuesve që në grupe t’i mendojnë dhe t’i diskutojnë mënyrat e ndryshme për t’iu përgjigjur këtyre shprehjeve, duke marrë parasysh përparësitë dhe dobësitë e tyre përkatëse. Proveni përgjigjet e tilla të ndryshme, si: “Prej nga e keni marrë këtë ide?”, ose “A e kuptoni se sa lënduese mund të tingëllojë kjo për disa njerëz?” Reflektoni se kur dhe si mund të jetë e përshtatshme t’ua prezantoni nxënësve konceptin “gjuha e urrejtjes”.

### 3. Si t’i inkurajojnë nxënësit të marrin parasysh këndvështrimet tjera

Mësuesit japin pikëpamjet e tyre mbi një numër çështjesh të diskutueshme. Kërkojuni atyre të zgjedhin një, për të cilën ata ndjehen më të sigurt, dhe të përpiqen të argumentojnë në favor të pikëpamjes së kundërt. Jepuni kolegëve një mundësi për të vënë në dyshim veten duke përvetësuar këtë rol. Përmbliidhni duke u kërkuar atyre të tregojnë atë që kanë mësuar nga përvoja në lidhje me pikëpamjet e tilla dhe njerëzit që i përkrahin ato. Reflektoni se kur dhe si mund të përdoret ky aktivitet me nxënësit në shkollë.

### 4. Si të parandalojmë shpërthimin e emocioneve në klasë

Kërkojuni mësuesve që në grupe të provojnë “depersonalizimin” e pyetjeve që mund t’i përdorin kur e lehtësojnë një diskutim në klasë, pra duke bërë pyetje shoqërore dhe jo personale. Për shembull, duke e ndryshuar pyetjen “Çfarë mendoni për punëtorët migrantë?” në “Çfarë mendojnë njerëzit për punëtorët migrantë?” Praktikoni me një sërë shembujsh. Diskutoni ndikimin që ky ndryshim i gjuhës mund ta ketë në diskutimet në shkollë dhe situatat ku mund të jetë i vlefshëm.



*Çështjet e diskutueshme - Tema 2: Trajtimi i çështjeve të diskutueshme në mënyrë të sigurt*

## **Menaxhimi i çështjeve të diskutueshme në klasë – Rolet e mësuesve?**

Ashtu si të gjithë të tjerët, mësuesit kanë të drejtë për pikëpamjet e tyre. Por kjo nuk do të thotë që ata duhet t'i ndajnë ato me nxënësit e tyre, ose që ata t'i favorizojnë pikëpamjet që janë në përputhje me të vetat. Pra, anën e kujt duhet ta marrë mësuesi gjatë një diskutimi në klasë?

Nuk është çështja për të marrë njërën anë apo tjetrën. Qëllimi është të ndihmohen nxënësit të mësojnë. Për t'i ndihmuar ata ta bëjnë këtë, ekziston **një varg rolesh që një mësues mund t'i luajë** në klasë. Këtu janë gjashtë role të ndryshme dhe situatat në të cilat mund t'i përdorni ato.

### **“UDHËHEQËSI I PAANSHËM”**

*Sigurohuni që të gjithë nxënësit janë në gjendje të shprehin një pikëpamje, por mos bëni komente. Përvetësojeni këtë rol kur nxënësit janë të informuar mirë dhe diskutimi është i balancuar si duhet*

### **“AVOKATI I DJALLIT”**

*Shprehni një pikëpamje të kundërt me atë që e shprehin nxënësit  
Aplikoni këtë rol kur shumica e nxënësve e shprehin opinionin e njëjtë*

### **“ALEATI”**

*Mbani anën e një nxënësi apo një grupi specifik të nxënësve  
Përdorni këtë strategji për të mbështetur nxënësit më të dobët apo grupin e marginalizuar*

### **“AUTORITETI PUBLIK”**


*Informoni nxënësit për pikëpamjen zyrtare  
Përvetësojeni këtë qëndrim kur merreni me çështje të të drejtave të njeriut, një politikë zyrtare të shkollës apo një dekret qeveritar*

### **“SHPJEGUESI”**

*Shpalosni një varg mundësish dhe argumentesh të ndryshme  
Rol i dobishëm kur nxënësit janë të pavetëdijshëm për pozicionet e ndryshme apo argumentet mbështetëse*

### **“QYTETARI”**

*Përvetësojeni këtë rol për ta bërë të ditur pikëpamjen tuaj  
Përdorni këtë strategji kur paanshmëria juaj vihet në dyshim nga nxënësit*





Çështjet e diskutueshme - Tema 3: Çështjet e diskutueshme në kurrikulë

## Çështjet e diskutueshme në kurrikulë – Ku dhe çfarë?

Kurrikula shpesh mund të jetë një burim kontradiktash në shkollë. Disa lëndë mësimore janë më të prirura për kontradikta sesa të tjerat. Këtu janë disa shembuj për t'i parë me kujdes.

- **Historia** – versionet kundërtëse të historisë së vendit tuaj
- **Edukimi për religjion** – pikëpamjet kundërtëse mbi moralitetin dhe të vërtetat religjioze
- **Edukimi shëndetësor** – qëndrimet kundërtëse ndaj seksualitetit dhe sjelljes morale
- **Edukata qytetare dhe shoqërore** – programet politike dhe ideologjitë kundërtëse
- **Letërsia** – pikëpamjet kundërtëse mbi moralin dhe qëndrimet sociale të shprehura në veprat letrare
- **Shkencat** – pikëpamjet kundërtëse mbi zbatimin e shkencës dhe përplasja me religjionin.

Si drejtor është e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm se njerëzit në komunitetin tuaj shkollor mund të shfaqin mospajtime të fuqishme me mënyrën se si shkolla juaj po i trajton disa prej këtyre çështjeve, p.sh. me versionin e historisë që mësohet në mësimet e historisë, ose me përdorimin e një libri të caktuar në letërsi.

Në shumë raste kurrikula është e detyrueshme dhe nuk keni fuqi për ta ndryshuar atë. Kështu që, kur keni shqetësime për mospajtime që dalin nga kontrolli, mund të keni nevojë ta adresoni situatën duke bërë një **deklaratë publike** për ta zbutur frikën rreth mënyrës se si shkolla juaj po e trajton çështjen në fjalë.

Sidoqoftë, në planin afatgjatë, strategjia më e mirë është që të sigurohet që stafi juaj mësimdhënës të jetë i vetëdijshëm për potencialin për kontradikta në lëndët që tyre dhe të kenë aftësitë e nevojshme për t'i zbutur çështjet e diskutueshme në mënyrë të sigurt.



Çështjet e diskutueshme - Tema 3: Çështjet e diskutueshme në kurrikulë

## Çështjet e diskutueshme në kurrikulë – Krijimi i mundësive për të biseduar

Ndonëse disa lëndë shkollore janë më të lidhura me polemika sesa të tjerat, në çdo lëndë në kurrikulë ka mundësi që të flisni për çështje të diskutueshme, nëse e dini se ku duhet të kërkonit. Diskutimi i këtyre çështjeve në klasë do të kontribuojë jo vetëm në edukimin demokratik të nxënësve, por edhe në të kuptuarit më të thellë të vetë lëndës.

Megjithatë, mësuesit e lëndëve jo gjithmonë e kuptojnë se këto mundësi ekzistojnë. Prandaj, përdorni këto dy aktivitete për ta ndihmuar stafin tuaj t'i identifikojë disa nga mundësitë.

### 1. 'PËRPTHJA E LËNDËVE'

Formoni grupe të përziera të mësimit nga lëndë të ndryshme mësimore. Kërkojuni grupeve të mendojnë shembuj të çështjeve që aktualisht janë të diskutueshme në shkollën, komunitetin ose shoqërinë tuaj. Identifikoni ato që tashmë janë të përfshira në kurrikulën e detyrueshme dhe vendosni ato në njërin anë. Kërkojuni grupeve të përqendrohen në çështjet që kanë mbetur dhe t'i vlerësojnë ato sipas rëndësisë së tyre të perceptuar për jetën dhe edukimin e nxënësve tuaj. Grupet pastaj zgjedhin çështjet më të rëndësishme dhe përpiqen të krijojnë lidhje midis tyre dhe lëndëve aktuale në kurrikulën tuaj shkollore. Sistemoni rezultatet nga grupet e ndryshme dhe kërkonit nga drejtuesit e lëndëve ose drejtuesit e aktivave lëndore të marrin në konsideratë se si mund t'i përfshijnë këto çështje në mësimitin e lëndëve të tyre.

### 2. 'TAKIMET E SHPEJTA NDËRKURRIKULARE'

Organizoni hapësirën me disa tavolina, me nga tri karrige në të dyja anët e secilës tavolinë. Ndani stafin tuaj në grupe me nga gjashtë persona, ku asnjëri grup nuk duhet t'i ketë dy mësues të së njëjtës lëndë. Organizoni secilin grup në tri çifte në tavolinë, me anëtarët e secilit çift që rrinë përballë njëri-tjetrit. Kërkojuni secilit çift që të identifikojë një çështje të diskutueshme që ndërlidhet me dy lëndët e tyre. Pas çdo disa minutave, lëvizni me rotacion – shtyni një vend tutje në tavolinë mësuesit dhe përsëritni procesin. Çiftet duhet të marrin shënime për sugjerimet e tyre, për t'i diskutuar më vonë në përmbledhjen me grupin e madh.



Çështjet e diskutueshme - Tema 3: Çështjet e diskutueshme në kurrikulë

## Çështjet e diskutueshme në kurrikulë – Lehtësimi i diskutimit


Si i paraqitni çështjet diskutueshme për diskutim në klasë? Të kërkuarit nga nxënësit që thjesht të marrin anë dhe të argumentojnë për ose kundër një propozimi, rrallë është e mjaftueshme. Kjo nuk e krijon drejtësinë për vështirësinë e çështjeve apo për mungesën e informacionit që disa njerëz kanë për to.

### 'PAJTOHEM, NUK PAJTOHEM, NUK E DI'

Në tri mure të klasës, vendosni shënimet 'PAJTOHEM', 'NUK PAJTOHEM' dhe 'NUK E DI'. Lexoni një deklaratë për një çështje të debatueshme, p.sh., "Është e gabuar të hani mish". Kërkojuni nxënësve që individualisht të reflektojnë rreth deklaratës dhe të shkojnë te muri që më së miri e reflekton mendimin e tyre, d.m.th. nëse ata pajtohen me të, nuk pajtohen me të, ose nuk e dinë se çfarë të mendojnë. Riorganizoni karriget dhe tavolinat në mënyrë që nxënësit të ulen në rresht përgjatë mureve që kanë zgjedhur, me fytyrë nga brenda. 'PAJTOHEM' dhe 'NUK PAJTOHEM' duhet të kenë përballë njëri-tjetrit, me 'NUK E DI' në murin anash tyre. Jepuni nxënësve mundësinë për të shprehur dhe diskutuar mendimet e tyre, me radhë, një person njëherësh, siç vijon:

- Anëtarët e grupit 'PAJTOHEM' ua drejtojnë argumentet anëtarëve të grupit 'NUK PAJTOHEM'
- Anëtarët e grupit 'NUK PAJTOHEM' ua drejtojnë kundërargumentet grupit 'PAJTOHEM'
- Grupet 'PAJTOHEM' dhe 'NUK PAJTOHEM' ndërveprojnë me argumentet e njëri-tjetrit
- Anëtarët e grupit 'NUK E DI' i shfaqin mendimet e tyre, sado të hutuar që mund të jenë, dhe kanë rast t'u bëjnë pyetje grupeve 'PAJTOHEM' dhe 'NUK PAJTOHEM'
- Grupet 'PAJTOHEM', 'NUK PAJTOHEM' dhe 'NUK E DI' ndërveprojnë me argumentet dhe pyetjet e njëri-tjetrit.

Ky lloj aktiviteti kërkon të paktën një orë e gjysmë, ndoshta edhe më shumë. Për ta përmbyllur, ju mund t'u kërkonit nxënësve të reflektojnë mbi gjendjen e opinioneve të tyre pas aktivitetit, të identifikojnë pikat më të spikatura të debatit, ose të marrin në konsideratë se si mund ta shqyrtojnë çështjen më në thellësi.



Çështjet e diskutueshme - Tema 4: Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës

## Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës – Të sigurt për të folur?

Si drejtor i shkollës, do të jeni të vetëdijshëm se cilësia e jetës së përditshme dhe e kulturës së shkollës mund ta bëjë dallimin se sa mirë mësojnë dhe arrijnë nxënësit. Është pikërisht e njëjta gjë edhe me çështjet e diskutueshme. Biseda rreth çështjeve të vështira mund të jetë e pakëndshme dhe shqetësuese për mësuesit, nxënësit dhe prindërit. Prandaj, është e rëndësishme të krijohet një kulturë e shkollës në të cilën njerëzit ndjehen të lirë të flasin hapur për çështje të ndjeshme, **pa frikë nga kritikata**.

### Kultura shkollore përkrahëse

Cilat janë elementet e një kulture të tillë? Një kulturë që ka të ngjarë të mbështesë diskutimin e çështjeve të vështira është ajo që është:

- **e sigurt** – gjithkush është i lirë nga ngacmimi, thirrja me emra dhe kanosja
- **mikpritëse** – gjithkush njihet si individ dhe ndihet pjesë e komunitetit të përbashkët të shkollës
- **e hapur** – gjithkush është i lirë t'i formojë, t'i provojë dhe t'i shprehë idetë e veta
- **përfshirëse** – gjithkush është në gjendje të marrë pjesë na baza të barabarta në çfarëdo aktiviteti të shkollës.
- **respektuese ndaj të drejtave** – të drejtat e njeriut të gjithkujt respektohen, posaçërisht liria e shprehjes, bindjeve e besimit, privatësia dhe liria nga trajtimi degradues
- **demokratike** – gjithkush merr pjesë në vendimmarrjen në shkollë.

### Rregullat e shkollës dhe politikave të sjelljes

Të pasurit e rregullave të duhura shkollore apo politikave të sjelljes dhe vënia në jetë e tyre në mënyrë të përshtatshme i kontribuon shumë krijimit të një lloji kulture që ju duhet. Kjo ka të bëjë shumë me rregullat që udhëzojnë sjelljet e përditshme në dhe përreth shkollës, ashtu sikur se edhe me rregullat që i përdorin mësuesit për të udhëhequr diskutimet në klasë.

A ka ndonjë fushë polemikash të cilën kultura mbizotëruese në shkollën tuaj i pengon mësuesit ta diskutojnë me nxënësit e tyre? Nëse po, cilat janë këto dhe pse?



Çështjet e diskutueshme - Tema 4: Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës

## Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës – Vlerësoni shkollën tuaj

Deri në çfarë mase etika dhe kultura mbizotëruese në shkollën tuaj inkurajojnë njerëzit që të flasin për çështje të vështira? Një mënyrë për të gjetur se sa është e hapur shkolla juaj ndaj këso lloj diskutimesh është të bëhet një studim i thjeshtë i qëndrimeve. Për të marrë një pamje të përgjithshme, do të jetë e rëndësishme të përfshihen prindërit, si dhe nxënësit e mësuesit.

Ja ku janë disa pyetje themelore që mund t'ia bëni çdo pale interesi në shkollë:

### STUDIMI I QËNDRIMEVE TË KULTURËS SHKOLLORE

Në këtë shkollë:

1. Si jeni të trajtuar nga të tjerët?
2. Sa i/e sigurt ndiheni?
3. Kur ekziston një problem a e dini kujt t'i drejtoheni?
4. Sa mendoni se dëgjoheni nga të tjerët?
5. Çfarë lloj mundësish keni që të shfaqni opinionet tuaja?
6. Sa shpesh keni rastin t'i diskutoni opinionet tuaja me të tjerët nga shkolla?
7. Çfarë ndikimi keni në rregullat e shkollës dhe vendimmarrje?
8. Si mendoni, sa mirë përzihen në mes vete nxënësit me prejardhje të ndryshme?
9. Sa mirëseardhëse është kultura shkollore për njerëzit me paaftësi, ata të gjinive dhe orientimeve të ndryshme seksuale, apo për ata që vijnë nga grupe të ndryshme etnike e religjioze?



Çështjet e diskutueshme - Tema 4: Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës

## Çështjet e diskutueshme dhe kultura e shkollës – Inkurajimi i zërit të nxënësve në klasë

Është e vështirë për nxënësit të përfshihen në diskutimin e çështjeve të diskutueshme nëse tashmë nuk janë mësuar ende për të folur publikisht në shkollë. Të ofruarit e mundësive të shpeshta nxënësve për të folur në klasë, i bën ata të mësohen për të shprehur veten para të tjerëve. Kjo i ndihmon ata të fitojnë besim për të folurit në publik dhe të bëhen më të aftë në këtë proces.

E rëndësishme është që nxënësit të ndjehen të dëgjuar kur flasin, dhe se mendimet e tyre respektohen.

Një mënyrë për të ndihmuar personelin tuaj të ofrojë mundësi të mjaftueshme për zërin e nxënësve në klasat e tyre, është krijimi i një liste kontrolli për planifikimin e mësimit. Pas përdorimit të listës së kontrollit për një kohë, mësuesit do të kuptojnë se po e ndjekin atë automatikisht. Ju gjithashtu mund ta përdorni një listë të tillë për monitorimin dhe vlerësimin e njësisë mësimore.

Ja një shembull:

### LISTA E KONTROLLIT PËR ZËRIN E NXËNËSVE

Në këtë njësi mësimore, a janë krijuar mundësi për nxënësit që të:

Bëjnë pyetje?
Shprehin një opinion?
Ndërveprojnë me të tjerët?
Bëjnë një sugjerim praktik?
Shfrytëzojnë votën?

